
 Republika e Kosovës	Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale		 Komuna e Istogut
	06 Nr.73/2020	Data: 14.05.2020	



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE-ISTOG

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shpallë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Mjek-e i/e Mjekësisë së Përgjithshme
Numri i referencës: 06.nr-73/020
Numri i Ekzekutuesve 3 (tre)
Niveli i Pagës: Koeficienti 565€
Kohëzgjatja e Emërimit: Me afat të caktuar - 1 (një) vit
Orët e Punës: 40 Orë

Punët dhe detyrat:

1. Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
2. Kujdesi për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanet, medikamentët dhe i zbaton masat tjera shëruese;
3. Ndhmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullatën në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
4. Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtim të pacientit;
5. Përshkruan dhe administron medikamente;
6. Udhëzon pacientët të specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore
7. Përpilon me shkrim raportet lidhur me punën dhe veprimet e tij;
8. Ndërmerr aktivitetet për edukimin shëndetësorë të popullatës;
9. Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikqyrësi në mbarëvajtjen e punës ku është i punësuar;
10. Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçant në lëmin në të cilin është trajnuar
11. Mban kujdestarinë sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
12. Kryen detyra të veqanta në lidhje me profesionin e tij.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare- Fakulteti i Mjekësisë drejtimi Mjekësia e Përgjithshme.

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:

1. Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
2. Të jetë i licencuar;
3. Përvoja e punës e dëshirueshme;
4. Shkathësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
5. Shkathësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
6. Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
7. Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e fakultetit të Mjekësisë;
 Certifikatën e Licencës;
 Dëshmi për përvojen e punës nëse ka;
 Dokumenti i Identifikimit.

Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Mjek Spec.- Gjinekolog.

Titulli i vendit të punës: Mjek/e spec.Gjinekologjisë

Numri i referencës: 06.nr-73/020

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i Pagës: Koefficienti: 330€

Kohëzgjatja e Emërimit: Me afat të caktuar - 1 (një) vit

Orari i Punës: 20 orë në javë.

Punët dhe detyrat:

1. Bëne egzaminimin klinik të pacieteve si shtatzëna ashtu edhe të atyre pa shtatzëni, percjell shtatzënin dhe gjendjen shëndetësore të shtatzënes në repart ose ambulanc-shtëpi.
2. Këshillon pacientin për qështje shëndetësore më qellim të uljes së rrezikut për sëmundje.
3. Punon në këshillimin për planifikim familjar dhe mbrohtjen ndaj sëmundjeve transmiseve.
4. Kryen veprime edukativo-shëndetësore për gratë në fazën riprodutive.
5. Referon pacientet në bazë të nevojës në shërbime sekondare dhe terciare.
6. Mbanë evidencën mjekësore të nevojshme me protokolet përkatëse.
7. Këshillon pacient dhe aplikon terapi për sëmundje seksualisht transmesive.
8. Ndjek në vazhdimësi aktivitetet e ndryshme të nderlidhura me zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
9. Kryen egzaminime me qëllime diagnostike, si marrja e materialit për Papa Test egzaminime me ultratingull dhe egzaminime tjera.
10. Ta respektoj kodin e veshjes.
11. Kryen edhe punë tjera nga lëmia përkatëse.

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e fakultetit të Mjekësisë – specilaizimi nga lëmia e gjinekologjisë.

Çertifikatën e Licencës;

Dëshmi për përvojën e punës nëse ka;

Dokumenti i Identifikimit;

Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit.

Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionet çdo ditë pune në Qëndren Kryesore të Mjekësisë Familjare – Istog -Zyra e Shërbimit Juridik dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njëjtën zyre.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahet intervista nga komisioni.

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.



DREJTORI
Dr. Mujë. Q. Osmanaj